

Transkript i Mbledhjes së Komisionit të Posacëm “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin” datë 10.07.2024 nga ekipi i Open Data Albania.

Fatmir Xhafaj: Përshëndetje,

Fillimisht në rend dite është miratimi i procesverbaleve të zbardhura të 2 mbledhjeve të mëparshme data 14 dhe 21 Qershor 2024. Ka dikush koment apo sugjerim me procesverbalet? Ka ndonjë koment? Jemi Dakord? Ok.

Pika e dytë është informim për zbatimin e mbledhjes së mëparshme të datës 21 Qershor. Komisioni ka marrë disa vendime që janë vendime kryesisht me karakter organizativ që kanë të bëjnë me procesin përgatitor për krijimin e normalitetit të punës së komisionit të posacëm dhe strukturave që do të ngrihen pranë tij. Siç është adresimi me një ftesë publike për bashkëpunim organizatave ndërkombëtare që veprojnë brenda dhe jashtë vendit; individëve; ekspertëve ndërkombëtarë dhe shtetasve shqiptarë jashtë vendit etj. për tu ofruar, për të shprehur interes, për të asistuar dhe për të ofruar ekspertizë në rolin e konsultetit në të 3 fushat objekt pune të këtij komisioni dhe rrjedhimisht dhe në 3 nëngrupet e këtij komisioni. Për zbatimin e këtij vendimi janë përgatitur ftesat.

Sëpari ftesat meqënëse është ftesë publike do publikohet në faqen ëeb të komisionit, e cila, unë besoj që në fund të kësaj jave do të jetë efciente dhe e përdorshme jo vetëm për ne, por edhe për publikun e gjërë dhe padyshim edhe për njoftime të kësaj natyre.

Vendimi tjetër i komisionit ishte adresimi i kërkesës për bashkëpunim kundrejt institucioneve publike të cilat ushtrojnë funksione në fusha me risk për korrupsion sipas vlerësimit që bëhet nga vetë raportet e Bashkimit European dhe kryesisht në fushën e prokurimeve publike; konsecioneve; shëndetësisë; arsimit ; tatimeve; doganave; pronave, pra kadastrës etj; Komisioni i ka dërguar kërkesat. Pothuajse të gjitha institucionet kanë kthyer përgjigje duke përcaktuar ekspertët, përfaqësuesit e tyre që do të atashohen, do të veprojnë pranë nëngrupeve dhe sidomos grupit të ekspertëve që merret me çështjet e korrupsionit dhe njëkohësisht kanë vënë në dispozicion edhe një serë dokumentash që do të jenë të nevojshme për të shqyrtuar gjatë procesit të analizës. Gjithsesi për korrektesë edhe në raport me, për një informacion, të kolegëve dhe informim të palëve të interesuara dhe opinionit publik, në zbatim të vendimeve të këtij komisioni, të mbledhjeve të mëparshme rreth 15 ftesa, ftesa për bashkëpunim iu është adresuar 15 organizatave të shoqërisë civile; 8 fakulteteve të universiteteve publike dhe atyre jo publike; 8 organizatave/shoqatave përfaqësuese të komunitetit dhe biznesit; 10 institucioneve të pavarura, po ashtu 10 agjensive ligjzbatuese dhe ndërkohë përgatur ftesat për rreth 10 organizata ndërkombëtare dhe misione të asistencës që veprojnë në Shqipëri dhe jashtë vendit dhe që një pjesë e tyre kanë shprehur interes për tu përfshirë në këtë proces.

Kjo është pak a shumë një pasqyrë e përgjithshme. Unë besoj se duke qenë se këtë javë përmbyllet procesi i kthimit të përgjigjeve nga institucionet, besoj se shumë shpejt do të kemi një vendimarrje për ta formalizuar grupin e ekspertëve me të tre nëngrupet e tij, si dhe sekretariatit teknik me të gjithë skuadrën që do të punojë në mbështetje të punës të grupit të ekspertëve.

Ndërkohë më duhet përsëri të falenderoj stafin e Kuvendit që është pjesë e Sekretariatit Teknik, posaçërisht zonjat që janë marrë me analizën e raporteve ndërkombtare dhe kryesisht atyre të BE, lidhur me gjetjet, vlerësimet dhe rekomandimet që kanë të bëjnë me këto 3 fusha që kemi objekt të punës së këtij komisioni.

Gjithashtu një falenderim të veçantë dua ti bëj Institutit të Kërkimeve Parlamentare, besoj se e shqiptova saktë, drejtuesit dhe ekipit të tij për studimin që kanë bërë për të adresuar, për të parë përvojat që ekzistojnë aktualisht, kryesisht në vende të tjera, në modele të tjera që janë të vendeve të ngjashme me ne, që kanë të bëjnë kryesisht me adresimin e çështjeve të luftës kundër korrupsionit. Unë besoj se ky është vetëm fillimi për kërkimet e Institutit. Ai është material shumë i dobishëm që do ti vihet në dispozicion në rradhë të parë anëtarëve të komisionit, por edhe ekspertëve që do të merren me këtë gjë dhe nga ana tjetër besoj se zonjat dhe zoterinjt që janë pjesë e kësaj skuadre që punon me Institutin do ta vazhdojnë punën e tyre kërkimore për ta thelluar më tej dhe për të hyrë pastaj në disa detaje që kanë të bëjnë me procese të tilla të ngjashme që janë zhvilluar në këto vende dhe kryesorja mbi produktet që kanë dalë nga këto procese të cilat do të jenë një vlerë e shtuar për grupet e ekspertëve.

Siç edhe dua të falendoj edhe pjesën e stafit që merret në mbështetje të komisionit dhe punë komunikimi publik për impenjimin që kanë pasur dhe që vazhdojnë të tregojnë në përgjigje të detyrave që kanë marrë përsipër. Edhe njëherë shumë faleminderit.

Tani vazhdojmë me pjesën tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë disa vendimarrje të rëndësishme që kanë të bëjnë me procesin përgatitor që janë të natyrës organizative por që theksojnë më së miri 4 elementët bazik themelorë përcaktues gjithë këtij procesi që është: gjithëpërfshirja; transparenca; profesionalizmi dhe standardet në zhvillimin e këtij procesi dhe në produktet që do të dalin prej tij.

Dhe në funksion të këtij qëllimi projektvendimi i parë që dëshiroj tju propozoj dhe që është hartuar nga stafi nga këshilltarët e komisionit të ngarkuar nga Kuvendi për të asistuar punën e këtij komisioni dhe që ka të bëjë me përfaqësimin e grupeve parlamentare me përfaqësues dhe ekspertë pranë 3 nëngrupeve të punës të ngritur pranë Komisionit të Posaçëm Parlamentar. Bazuar në nenin 24 dhe vijues të rregullores së Kuvendit dhe në pikën 8 paragrafi 2 të vendimit nr. 50 të Kuvendit për krijimin e këtij Komisioni të Posaçëm ju propozoj që ky Komision i Posaçëm t'ju drejtohet grupeve parlamentare të regjistruara në Kuvend që nëse e çmojnë të arsyeshme të propozojnë përfaqësuesit/ekspertët me të cilët dëshirojnë të përfaqësohen për të prezantuar kontributet përkatëse në emër të grupeve të tyre parlamentare pranë grupit të ekspertëve dhe sekretariatit teknik, struktura të ngritura pranë Komisionit të Posaçëm Parlamentar, konform parashikimit të vendimit nr. 50 të Kuvendit.

Pika 2: Secili grup parlamentar mund të propozojë vetëm një 1 përfaqësues/ekspert pranë çdonjërit prej 3 nëngrupeve të ekspertëve dhe 3 nëngrupeve të sekretariatit teknik.

Për ta bërë të qartë edhe më shumë, për kolegët është e qartë, por për ta bërë të qartë edhe për një lloj transparence publike. Ideja është që secili nga grupet parlamentare të mund të dërgojë një përfaqësues apo ekspert pranë secilit nga grupet, pra cdo grup parlamentar mund të sjellë 3 ekspertë të vetët, nga 1 pranë secilit nëngrup si për grupin e ekspertëve ashtu edhe për sekretariatit teknik,

të cilët natyrisht nuk do të jenë anëtarë të këtyrë grupeve, por të atashuar pranë tyre dhe do të mund të prezantojnë për të prezantuar pikëpamjet grupeve të tyre politike për çështjet që debatohen, diskutohen dhe vendimet që merren në grupin e ekspertëve. Kjo edhe për shkak sepse ajo është një tribunë që është konceptuar se do të jetë një mekanizëm, i cili do të funksionojë në liri të plotë dhe i pavarur në vendimarrjet e veta që do ti propozohen më pas komisionit për shqyrtim dhe është shumë mirë që ato të njohin edhe pikëpamjet e grupeve politike parlamentare përpara se të mbyllin gjatë procesit të hartimit dhe përmbylljes së drafteve që do ti paraqiten komisionit për shqyrtim.

Kush është dakord? Ka ndonjë koment?

Erion Braçe: Ne kemi një anomali, e kemi në krahun e opozitës. Jo të gjithë deputetët e opozitës janë të përfaqësuar në grupe parlamentare, një realitet të ri që ka ndodhur javët e fundit. Kështu që do të duhet të gjejmë në mundësi se si edhe këta deputet që nuk përfaqësohen në grupe parlamentare të kenë mundësi që edhe të jenë pjesë dhe të informohen për këtë gjë.

Fatmir Xhafaj: Ndoshta është një çështje që ha diskutim, duhet diskutuar por kini parasysh në vendimin nr. 50 të Kuvendit në pikën 12 ne kemi parashikuar: “Çdo parti tjetër jo parlamentare që nuk është përfshirë në këtë komision do të ftohet të marrë pjesë në aktivitete të hapura, si dhe të ofrojë kontribute konkrete pranë komisionit dhe grupit të ekspertëve”. Kjo nënkupton edhe partitë e tjera parlamentare pavarësisht se mund të mos jenë grup për më tepër ato jemi të detyruar ti ftojme dhe tu kërkojmë të ofrojnë kontribut, si mund ta bëjmë këtë gjë?

Nuk mundet që secili nga ata duke mos qenë një grup i rregjistruar si i tillë në formën e njohur nga Rregullorja e Kuvendit ti kërkojmë të atashojë një ekspert por, e para duhet tu japim mundësinë që deputetët që mund të kenë ide, mendime, propozime lidhur me dokumentat që grupet e ekspertëve do të shqyrtojnë dhe në do të miratojmë do të shprehen ose në një mbledhje të hapur të këtij komisioni ose në një tryezë të krijuar nga ky komision ose drejtpërdrejt me propozime konkrete. Unë kam pasur rastin që disa nga kolegët deputet më kanë kërkuar që në një moment të përshtatshëm të paraqiten në komision sepse dëshirojnë të shfaqin pikëpamjet e tyre për çështje të ndryshme dhe sigurisht që janë të mirpritur. Askush nuk e ndalon deputetin në cdo kohë dhe conform rregullores dhe procedurave përkatëse të marri pjesë në aktivitete të kësaj natyre. Por gjithsesi duhet parë se si mund ta vendosim në një procedurë normale dhe barazie për të gjithë, gjithë angazhimin dhe kontributin e grupeve parlamentare por edhe të kolegeve të tjerë deputet që janë pjesë e parlamentit apo partive jashtë parlamentare, sic është theksuar në vendimarrjen e Kuvendit.

Ok ka tjetër? Biem dakord? Z. Braçe jemi ok? Ka koment tjetër? E miratojmë atëherë? Ok e miratojmë, faleminderit.

Projektvendimi i dytë është për përfaqësimin e institucioneve të drejtësisë me përfaqësues, ekspertë dhe profesionistë pranë grupit të ekspertëve dhe sekretariatit teknik në Komisionin e Posaçëm Parlamentar. Bazuar në nenin përkatës të Rregullores së Kuvendit dhe nenin 8 të vendimit në Rezolutën e Kuvendit nr. 50, Komisioni i Posaçëm Parlamentar vendosi:

- Tu drejtohet me një ftesë për bashkëpunim të gjitha institucioneve dhe organeve që janë pjesë të sistemit të drejtësisë dhe që ushtrojnë funksione në fushën e drejtësisë që të propozojnë përfaqësuesit e tyre më të cilët do të përfaqësohen për të asistuar dhe kontribuar në çështjet dhe veprimtaritë e kësaj fushe që do të trajtohen e zhvillohen nga Komisioni i Posaçëm Parlamentar. Këtu është fjala për, që të jemi të qartë: Këshillin e Lartë të Prokurorisë; Këshillin e Lartë Gjyqësor; Inspektorin e Lartë të Drejtësisë; Strukturën e Posacme Antikorrupsion; Prokurorinë së Përgjithshme; SPAK; Dhomën Kombtare të Avokatisë dhe Shkollën e Magjistraturës në qoftë se nuk kam harruar ndonjë tjetër.
- Të ftojë gjithashtu institucionet e lartpërmendura që të propozojnë ekspertët e tyre më të mirë nga rradhët e gjyqtarëve; prokurorve; avokatëve; pedagogëve të Shkollës së Magjistraturës, të cilët do të krijojnë grupin e ekspertëve pranë grupit të ekspertëve të Komisionit, strukturë që do të angazhohet me hartimin e analizës për sundimin e ligjit në fushën e drejtësisë, hartimin e planit përkatës të veprimit; si dhe do të sugjerojë propozime për ndryshime të mundshme ligjore dhe institucionale që do ti propozohen komisionit të posaçëm parlamentar për shqyrtim dhe miratim. Në mbështetje të punës të grupit të ekspertëve institucionet ftohen të propozojnë nga rradhët e stafit, këshilltarëve dhe asistentëve të tyre profesionistë që do të krijojnë nëngrupin e tyre të punës përkatës të ngritur pranë sekretariatit teknik.

Nga përmbajtja e këtij projektvendimi koncepti është paksa i ndryshëm nga ajo cfarë kemi miratuar në mbledhjen e mëparshme por që buron edhe nga fryma e rezolutës edhe e vetë vendimit që nënkupton që këto institucione do të krijojnë një nëngrup me ekspertët e tyre pranë grupit të ekspertëve dhe me profesionistë, përfaqësuesit e tyre, përfaqësues nga stafet e tyre që do të ndihmojnë këtë nëngrup pranë sekretariatit teknik.

Pra janë ata vetë të cilët do të diskutojnë për çështje që kanë sot lidhur me fushën e veprimit të tyre, janë ata vetë që do të punojnë sëbashku me grupin e ekspertëve për të bërë analizën dhe po ata vetë përmes një debate dhe diskutimi të brendshëm dhe publik sipas frymës së rezolutës dhe vendimit të Kuvendit do të miratojnë analizën për fushën e tyre dhe më pas planin e veprimit dhe propozimet përkatëse. Kto janë pak a shumë, kjo është përmbajtja e këtij projektvendimi.

Kemi komente për këtë gjë? Ka ndonjëri ndonjë koment për këtë? Ok, atëherë, dakord, miratohet.

Projektvendimi tjetër është një ftesë publike për bashkëpunim drejtuar organeve të medias audiovizive, medias së shkruar, medias online, dhe asaj elektronike për të shprehur interesin për të kontribuar me ekspertizën e tyre teknike në veprimetainë e komisionit parlamentar dhe grupit të ekspertëve, dhe bazuar në frymën e rezolutës; rregullores së Kuvendit, nenet përkatëse të rregullores së Kuvendit dhe në pikën 8 të vendimit nr. 50 të Kuvendit, Komisioni i Posaçëm Parlamentar vendosi tu drejtohet me një ftesë publike për bashkëpunim organeve të medias audiovizive, medias së shkruar, medias online, dhe asaj elektronike që kanë në fokus të angazhimit të tyre trajtimin e çështjeve që lidhen me 3 fushat kryesore object pune të këtij komisioni: Mirëqeverja; Antikorrupsioni dhe Sundimi i Ligjit për të shprehur interesin për përfshirje aktive në aktivitetet e organizuara nga Komisioni i Posaçëm Parlamentar si dhe për të ofruar kontributin e tyre në këtë proces pranë grupit të ekspertëve. Këtu qëllimi i këtij projektvendimi është për ta zgjeruar gjithëpërfshirjen, ekspertizën, por edhe pak më shumë për ta përfshirë më mirë oponencën

kritike për çështje të tilla kaq të rëndësishme, që do të thotë: Ne po u bëjmë një ftesë publike për bashkëpunim, e cila do të botohet më pas edhe në faqen e Komisionit dhe të Kuvendit, që fton që ato media që kanë qenë të angazhuara, janë të angazhuara, secila nga to që dëshiron të jetë pjesë e këtij procesi, të vërë në dispozicion shkrime, analiza, komente që ato kanë bërë për çështje të tilla me interes të vecantë siç janë këto 3 fusha: mirëqeverja, antikorrupsioni dhe sundimi i ligjit dhe njëkohësisht të japin opinionin e tyre vlerësimin e tyre tashmë jo thjesht për të informuar publikun, por edhe për të kontribuar dhe për të adresuar çështje që kanë të bëjnë me këto 3 fusha objekt i punës së komisionit. Natyrisht është në çmimin e secilit prej tyre të shprehin interesin për të kontribuar me një prani permanente përfaqësuesish pranë grupit të ekspertëve, jo si pjesë e grupit të ekspertëve.

Së dyti për të marrë pjesë në tryezat e debatit që do të organizojmë dhe së treti për të ofruar kontribut që janë pjesë normale të veprimtarisë të tyre që mund të mos kenë qënë në vëmendjen tonë apo në vëmendjen e institucioneve përgjegjëse gjatë këtyre viteve por që në vlerësimin e tyre kanë interes publik. Kjo besoj do të jetë një vlerë e shtuar, një kontribut i rëndësishëm në procesin e hartimit dhe analizës dhe më pas në planin e veprimit. Ky është në thelb dhe në formë përmbajtja e këtij projektvendimi.

Ka komente për këtë?

Milva Ekonomi: Jo unë nuk kam ndonjë koment, po mendoja se lista do të jetë shumë e gjatë, po shikoja vendimin ku edhe forma e thirrjes është organizuar ndryshe nga tjerat. Dmth si fillim ato shprehin interesin dhe pastaj ne i thërrasim në grupet tona të punës. Kështu që e kam të qartë. Faleminderit.

Fatmir Xhafaj: Ideja është të këtë shprehje interesi sepse janë numër i pafund nga ato që dëshirojnë, dhe e ndjen veten të aftë dhe të nevojshme dhe ne mbajmë parasysh që në debatet publike, ato kanë një ftesë jo thjesht për të pasqyruar aktivitetin, por për të qënë prezent dhe aktor i tryezave dhe për të kontribuar përmes komenteve, vlerësimeve; prpozimeve; kritikave që mund të adresojmë për çështje të caktuara. Nëse ka formulë tjetër pastaj e shikojmë në ndërtim. Ne do ta bëjmë publike, se ëshë e pamundur.

Evis Kushi: Ndoshta për shkrimet duhet ta diskutojmë pak sepse kto media, çdo ditë shkruajnë pafund dhe ju thatë pak më parë që janë të ftuar të sjellin dhe shkrime dhe nuk e di se sa duhet ne ti konsiderojmë.

Fatmir Xhafaj: Nuk e kisha vetëm për shkrime të natyrës informative, thjesht analiza që mund të kenë bërë, që mund të cojnë në përfundime, e para për të njohur fenomene që mund të kenë qënë jashtë vëmendjes tonë në një periudhë të caktuar dhe duke ardhur si kontribut në këtë moment që ne jemi të fokusuar në çështje të tilla, sondazhe që mund të kenë, cfarë ato mund të kenë pasqyruar. Ato mund të kenë bërë analiza për çështjet e korrupsionit, ndoshta edhe në numra të tërë, për çështje të caktuara që kanë të bëjnë me luftën kundër korrupsionit apo sundimin e ligjit apo mirëqeverisjen, kjo mbetet në qasjen e tyre. Dakord e miratojmë? Ok, faleminderit.

Kto ishin 3 vendimet që kishim parashikuar për mbledhjen e sotme të komisionit. Ka dikush diçka?

E mbyllim edhe njëherë faleminderit dhe faleminderit dhe stafit. Për mbledhjen e ardhshme do ju njoftojmë shumë shpejt.

**Video e transkriptuar është aksesuar në faqen Facebook të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë datë 10.07.2024 në link:*

<https://www.facebook.com/share/v/4LEYE1ucbuwUYNza/?mibextid=WC7FNe>